




Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 26

Datë : 13.04. 2023.

KONTRATË PROKURIMI NR 21

62500-23-2440-1-3-6/C656

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
"PRO MEDICAL" SH.P.K ME SELI NË FERIZAJ 811394212 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër,
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

FURNIZIM ME MATERIAL STOMATOLOGJIK

me numër identifikues:

Nr. i Prokurimit ¹	62500-23-2440-1-3-6
Nr i brendshëm	62500-23-016-136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : FURNIZIM ME MATERIAL STOMATOLOGJIK.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë : QKMF Dr. " Shpetim Robaj " K.Malishevë.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 2,445.00 (dymijëekatërqindëekatërdhjetëepesëeuro)Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.




6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **SHQIPE**³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Adnan Bala
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13.04.2023	Data:	13.04.2023
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 62500-22-6045-1-3-6/C524

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Nuk aplikohet.
Programi i ekzekutimit	11	OE Furnizimin me material stomatologjik për nevojat e QKMF-së Dr.“ Shpëtim Robaj ” në Malishevë duhet ta kryej në afatë prej 10 ditëve që nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Menaxhimi i Kontrates	12	Menaxhimin e kontratës do ta bëjë zyrtari i QKMF-së z.Sabri Badallaj i caktuar nga ZKA i AK-së. Menaxheri i kontratës është përgjegjës për mbikqyrjen e ekzekutimit të Furnizimin me material stomatologjik gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të furnizimit e deri në përfundim të kontratës. Menaxheri i projektit do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjatë furnizimi duke filluar nga dita e parë e deri në përfundimin e kontratës përkatësisht ekzekutimin e kontratës. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësin dhe sasinë e furnizimit. AK e ruan të drejtën që t'ia ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe sasinë në afatë dhe ne përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës .
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	13	Të gjitha i përkasin OE.
Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimin me material stomatologjik duhet të jetë në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri të plotë në specifikacionin e ofertës. Nëse furnizimi nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.

Pagesa	20.1	<u>Pagesa do të bëhet në Euro.</u> Obligohet AK që pasi ta e pranon raportin e pranimi të Furnizimit me material stomatologjik nga zyrtari z.Sabri Badallaj (menaxheri i kontratës) si dhe faturen nga OE të ia paguaj shumen sipas nenit 4 dhe 4.1 të kësaj kontrate.
Dorëzimi	21.3	Vendi i dorëzimit të Furnizimit me material stomatologjik do të jetë në QKMF Dr."Shpetim Robaj" në Malishevë.
Vonesat në ekzekutim	25	Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministris së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË
DREJTORIJA E SHËNDETSISË



Material hargjues për pensionistë me gravura dhe mirenjohje për pensionistë 2020

Nr	Përshkrimi i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi ME Tvsh	Shuma totale me Tvsh
1	Amp.Lidocain me andrenalin	amp	4000	0.20 €	800.00 €
2	Lidocain spray	pako	20	6.50 €	130.00 €
3	Heli pllomba	tuba	60	6.20 €	372.00 €
4	Heli Band	pako	8	8.00 €	64.00 €
5	Helio pllomba flow	tuba	10	6.00 €	60.00 €
6	Fosfat cement	pako	10	8.50 €	85.00 €
7	Zook (zink-oksid)	pako	5	6.50 €	32.50 €
8	Freza diamanti (terma të ndryshme)	copë	200	0.50 €	100.00 €
9	Freza celiku te mesme dhe të mëdha)	copë	200	0.55 €	110.00 €
10	Vaterolne	kg	8	9.50 €	76.00 €
11	Solutio Klumski	pako	8	4.50 €	36.00 €
12	Trison pasta	pako	2	26.00 €	52.00 €
13	Skalpera steril	pako	2	6.00 €	12.00 €
14	Depulpin (Devites	tuba	5	12.00 €	60.00 €
15	Vaj per turbina	copë	1	8.00 €	8.00 €
16	Jod form, gaza	pako	2	25.00 €	50.00 €
17	Citodur (mbushje e perkosishme)	pako	8	3.00 €	24.00 €
18	Acid ortofosforik %(50ml)	tuba	8	4.00 €	32.00 €

19	Alveozhil	pako	4	19.00 €	76.00 €
20	Kalcimol(forcohet me helio)	tuba	5	16.00 €	80.00 €
21	Leter artikuluese (të kalterta)	pako	4	3.00 €	12.00 €
22	Kavacid sol. 750ml	copë	4	7.00 €	28.00 €
23	Tuba plastik per aspirim te ajrit	copë	1000	0.03 €	30.00 €
24	Traka poliruese	pako	3	4.50 €	13.50 €
25	Goma poliruse	copë	20	0.50 €	10.00 €
26	Traka celuloide	pako	5	2.00 €	10.00 €
27	Endofill (për mbushej kanali)	pako	1	13.00 €	13.00 €
28	Hipoklorit Na 2,5%(per dezinfektim kanali)	pako	2	4.50 €	9.00 €
29	Kerr gjilpera per zgjerim kanali 15x22	pako	5	2.20 €	11.00 €
30	Hidrogjen 3%	liter	5	3.00 €	15.00 €
31	Brusha metalike per pastrimin e instrumenteve	copë	10	2.00 €	20.00 €
32	Brusha metalike per pastrimin e dhëmbëve)	pako	20	0.50 €	10.00 €
33	Purodent pastë për pastrimin edhëmbëve)	pako	2	2.00 €	4.00 €
	TOTALI				€ 2,445.00